

# Qytetarë kujdes nga rriqrat!

Rriqrat tashmë kanë filluar të pickojnë!

Kujdesuni nga pickimi i rriqnave sepse ato nuk fluturojnë as nuk i afrohen njerëzve!

Përmbajuni rekomandimeve të Institutit Kombëtar që të mbroheni nga Ethet hemorragjike!

Në vatrat endemike ka filluar pickimi i rriqrave që është paralajmërimi i parë për mundësinë e shfaqjes së sëmundjes. Numri i të pickuarëve ka arritur në 602 në komunën e Malishevës, 257 raste në komunën e Suharekës, 177 raste në komunën e Klinës dhe 94 raste në komunën e Rahovecit si pasojë e qëndrimit në livadhe të pa kositura, shkurre dhe shtalla dhe veshmbathjes jo adekuate.

Kujdesi duhet të jetë i madh nga qytetarët sepse nga pickimi tashmë nje person është diagnostikuar me ethe hemorragjike me gjendje të përkeqësuar klinike.

Tashmë ekipet profesionale po bëjnë repelimin e kafshëve.

Instituti Kombëtar rekomandon qytetarët për sivjet:

1. Mos qëndroni gjatë dhe pa nevojë në livadhe dhe vende me shkurre,
2. Nëse patjetër duhet të jeni të pranishëm në këto vende vesh rroba të gjata dhe pantallonat futni në çorapë,
3. Duhet të përdorni preparate me të cila lyejmë pjesët e trupit të cilat i dëbojnë insektet nga trupi i njeriut e sidomos në pjesët e zbuluara të trupit, (shuplakat, qafën),
4. Kontrolloni trupin mos keni ndonjë rriqër gjatë qëndrimit në vatër,
5. Kontrolloni përsëri trupin pas largimit nga livadhi apo vendet me shkurre,
6. Nëse keni rriqër në trup ofrohuni në qendrën më të afërt mjekësore sa më shpejt,
7. Kositja e barit të bëhet në vazhdimësi (oborr dhe livadhe),

8. Pastrimi dhe dezinfektimi i stallave të bëhet në vazhdimësi,
9. Mbajtja e higjienës personale në nivelin më të lartë.



Lusim RTK dhe mediat elektronike të emitojnë filmin për ethet hemorragjike.

### [Rekomandime për Ethet Hemorragjike Krime Kongo](#)

*Rekomandime për Ethet Hemorragjike Krime Kongo* Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës po përcjell në mënyrë permanente situatën epidemiologjike me Ethet

Hemorragjike Krime-Kongo në të gjitha vatrat e infeksionit dhe bashkë me mjekët dhe punëtorët shëndetësor të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë, Rahovec, Klinë, Suharekë, Gjakovë edhe sivjet do të vazhdojnë mbikëqyrjen dhe hulumtimin epidemiologjik të të gjitha vatrave, përfshirë këtu edhe vatrat endemike të komunave fqinje: Lipjan, Drenas, Skenderaj, Prizren, Dragash. Instituti Kombëtar tashmë është në gjendje gadishmërie për të ndërmarra masat profilaktike dhe kundërepidemike për të parandaluar epideminë e EHCC të planifikuara me kohë dhe të përfshira në Planin Operacional për parandalimin dhe luftimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo në Kosovë. Duke pasur parasysh se që nga viti 2013 nuk është shënuar asnjë rast fatal me EHCC pasi që kemi realizuar me sukses masat profilaktike dhe kundërepidemike, ne duhet të vazhdojmë realizimin e aktiviteteve në terren sepse kemi të bëjmë me një sëmundje endemike, vdekjeprurëse dhe praninë e rriqrave në vatrat endemike të cilat bartin virusin e EHCC. Edhe pse rreziku nga ethet hemorragjike është më i vogël se vitet e kaluara, qytetarëve u bëhet apel që edhe më tutje të vazhdojnë të kenë kujdes nga pickimet e rriqrave, sidomos në zonat Malishevë, Rahovec, Suharekë dhe Klinë pasi që tashmë temperaturat kanë filluar të ngriten dhe rriqrat kanë filluar të dalin në sipërfaqe të tokës. Laboratorët e Institutit Kombëtar janë të përgaditura dhe të gatshme për diagnostikimin e të gjitha rasteve të dyshimta në EHCC. Instituti Kombëtar rekomandon qytetarët për sivjet: 1. Mos qëndroni gjatë dhe pa nevojë në livadhe dhe vende me shkurre, 2. Nëse patjetër duhet të jeni të pranishëm në këto vende vesh rroba të gjata dhe pantallonat futni në çorapë, 3. Duhet të përdorni preparate me të cilat lyejmë pjesët e trupit të cilat i dëbojnë insektet nga trupi i njeriut e sidomos në pjesët e zbuluara të trupit, (shuplakat, qafën), 4. Kontrolloni trupin mos keni ndonjë rriqër gjatë qëndrimit në vatër, 5. Kontrolloni përsëri trupin pas largimit nga livadhi apo vendet me shkurre, 6. Nëse keni rriqër në trup ofrohuni në qendrën më të afërt mjekësore sa më shpejt, 7. Kositja e barit të bëhet në vazhdimësi (oborr dhe livadhe), 8. Pastrimi dhe

dezinfektimi i stallave të bëhet në vazhdimësi,9. Mbajtja e higjienës personale në nivelin më të lartë,Instituti Kombëtar bënë thirrje te qytetarët se duhet të punojnë në faktorët e përmirësimit të ekosistemit që nënkupton:1. Të punohen të gjitha tokat e punueshme,2. Të kositen të gjitha livadhet me kohë dhe nga disa herë, 3. Të pastrohen kopshtet dhe pronat për rreth shtëpive, 4. Të pastrohen fermat ku mbahen bagëtitë dhe të largohen rriqrat nga trupi i kafshëve,5. Të kihet kujdes në veshmbathje për të gjithë fermerët dhe anëtarët e tyre të familjeve që punojnë në fushë ku kurrsesi nuk guxohet të lihen këmbët e zbathura6. Fëmijët mos të lejohen të luajnë në livadhe e kopshte të pakositura dhe në mbrëmje të kontrollohet prania e rriqrave në tërë trupin.

Posted by [Instituti Kombëtar I Shëndetësisë Publike të Kosovës](#) on Tuesday, 5 March 2019